



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 2317/Prot.

Tiranë, më 26.03 2023

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1756, datë 21.05.2015.

SHOQËRISË “FUSHË KRUJA CEMENT FACTORY” SH.P.K

Fabrika e çimentos, Fushë Krujë, Durrës.

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA**

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “FUSHË KRUJA CEMENT FACTORY” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1756, datë 21.05.2015, për mineralin gur gëlqeror, në Objektivin “Fushë Krujë”, Bashkia Krujë, Qarku Durrës.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 1284, datë 27.02.2023, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 2317, Prot., datë 28.02.2023, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1756, datë 21.05.2015, për mineralin gur gëlqeror, në Objektivin “Fushë Krujë”, Bashkia Krujë, Qarku Durrës, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit që prej vitit 2017 deri në vitin 2022.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr. 1756, datë 21.05.2015, për mineralin gur gëlqeror, në Objektivin “Fushë Krujë”, Bashkia Krujë, Qarku Durrës që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1756, datë 21.05.2015, për mineralin gur gëlqeror, në Objektivin "Fushë Krujë", Bashkia Krujë, Qarku Durrës, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

